



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.01.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të muajit nëntor 2019 për datat 6, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 21, 22.
2. Shqyrtimi i aktit normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar”.
3. Shqyrtimi i aktit normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Arben Elezi, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Reme Lala, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ylli Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Korab Lita, Eljo Hysko,

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Përshëndetje!

Kuorumin e kemi dhe besoj se për ne nuk është fare problem të kemi një mbledhje të suksesshme në vendimmarrje. Me axhendën jemi njohur të gjithë paraprakisht dhe e kemi parë atë edhe në mënyrë elektronike, por sekretaria na ka ndihmuar ta kemi atë edhe në *hard copy*.

Në rendin e ditës sot kemi disa çështje për diskutim. Së pari, miratimin e procesverbaleve të muajit nëntor 2019 për datat 6, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 21, 22. Besoj se i keni marrë në formë elektronike. Besoj fort që keni bërë komente, keni mendime shtesë apo kohë tjetër, kështu që kalojmë në proces miratimi pak më vonë.

Kemi për të shqyrtuar aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar”. Relatore është zonja Blerina Gjylameti.

Gjithashtu, kemi edhe shqyrtimin e aktit normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”. Relatore është zonja Evis Kushi.

Duke qenë se detyrën si kryetare e këtij komisioni e kam marrë për herë të parë, pata nevojë të konsultohesha me zonjën Kushi, e cila është relatore e aktit normativ për t’u informuar për çështjet e diskutuara, të përgatitura, çfarë informacionesh keni marrë nga komisionet e tjera dhe bashkëpunimin që keni pasur me ta për këtë çështje dhe, pasi bëra një konsultim, konkludua që mbase për nevojat e informacioneve shtesë që duhet të marrë zonja Kushi, ta shtyjmë për një ditë tjetër diskutimin, sepse informacionet nuk kanë arritur akoma te relatorja dhe as në komision. Kështu që, zotit Majko, që e kemi të ftuar special në këtë komision për të mbrojtur këtë akt normativ, do t’i kërkojmë të na mirëkuptojë, pasi informacioni nuk ka ardhur ende. Ne do t’ju njoftojmë në një moment të dytë se kur do të diskutohet akti normativ, që do të bëhet shumë shpejt, ndoshta që nesër.

Jeni dakord të bëjmë këto ndryshime në axhendën që kemi përpara? Jemi dakord të marrim në konsideratë këto ndryshime që propozuam? Të shtyjmë për një moment të dytë aktin normativ dhe të diskutojmë këto dy çështje që kanë mbetur në axhendë.

Artur Roshi – Kryetare, mirë se erdhe dhe punë të mbarë!

Mendoj se e kemi të mjaftueshëm informacionin që na ka ardhur dhe nuk kemi pse ta shtyjme për një kohë të dytë. Nuk ma merr mendja që relatorja nuk e ka informacionin në lartësinë e duhur për të bërë relatimin e aktit. Ky është mendimi ynë.

Pandeli Majko – Jam i gatshëm të bashkëpunoj me relatoren për çdo detaj që ajo e konsideron të vlefshëm, por, nëse duhet informacion shtesë, unë jam i gatshëm ta ofroj atë sot për të gjithë kolegët.

Milva Ekonomi - Unë personalisht mendoj se për sa kohë ne patëm nevojë për informacion shtesë, sepse asgjë nuk ka mbërritur ende në komision, kjo çështje të shtyhet. Ne mund ta diskutojmë edhe sot, edhe nesër, por, meqenëse relatorja ka nevojë të informohet për çështjet që ka kërkuar, do t'ju lutesha ta mirëkuptojmë në këtë rast.

Pandeli Majko – Unë e thashë, jam i gatshëm t'i jap relatores çdo lloj informacioni. Nëse relatorja ka pyetje për mua, unë jam i gatshëm t'i përgjigjem këtu në komision. Unë vij në emër të qeverisë dhe kam të gjithë informacionin për këtë çështje.

Tani pata një telefonatë me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave ku diskutuam detaje të vazhdimin të situatës. Jam i gatshëm të vij edhe nesër, pa diskutim, se parlamenti është superior.

Antoneta Dhima - Zonja kryetare, unë mendoj të vazhdojmë shqyrtimin e çështjes së parë deri në një moment tjetër, nëse ju bini dakord.

Milva Ekonomi - Në rregull. Zoti Majko, besoj se duhet të bëni pak durim.

Kalojmë te rendi i ditës. Kush është dakord me miratimin e procesverbaleve për muajin nëntor?

Miratohe.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, shqyrtimi i aktit normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar”. Relatore kemi zonjën Gjylameti dhe më pas fjala do t'u kalojë përfaqësuesve të Ministrisë së Financave.

Zonja Gjylameti, fjala është për ju. E gëzofsh ditën sot!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetare!

Suksese në këtë detyrë! Mirë se erdhe te ne!

Unë do të relatoj projektligjin për miratimin e aktit normativ të Këshillit të Ministrave të datës 24.12.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar”.

Rishikimi i buxhetit në mes të vitit është një instrument ligjor dhe praktikë e konsoliduar ndër vite, i cili mbështetet në:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Nëpërmjet këtij akti normativ, buxheti i vitit 2019 është ndryshuar për herë të dytë (ndryshimi i parë u miratua në tetor 2019). Ndryshimet buxhetore, të miratuara nga Kuvendi në tetor 2019, nuk prekën treguesit kryesorë makroekonomikë, të parashikuar në fillim të vitit. Ato mundësuan rritjen e financimit për pushtetin vendor, në përputhje me ecurinë pozitive të mbledhjes së të ardhurave prej tij; financimin e dëmeve të tërmetit të datës 21 shtator 2019; mbështetjen e funksionimit të sistemit të drejtësisë; si dhe rialokimin e shpenzimeve korrente e kapitale drejt projekteve të rëndësishme të ekonomisë.

Akti normativ i Këshillit të Ministrave nr.11, datë 24.12.2019, synon të rialokojë shpenzimet midis zërave e institucioneve buxhetore, për të siguruar burimet për dhënien e shpërblimit të pensionistëve në fund të vitit, mbështetjen sociale ndaj shtresave në nevojë, si dhe realizimin sa më optimal të planit nga ministritë dhe institucionet buxhetore.

Karakteristikat kryesore të ndryshimeve buxhetore, përmes këtij akti normativ, janë:

Së pari, duhet të ruhen të pandryshuar parametrat kryesorë makroekonomikë, të parashikuara në fillim të vitit, për të vijuar qëndrueshmërinë e financave publike.

Akti normativ nuk parashikon ndryshime në të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit. Deficiti buxhetor, si një tregues makroekonomik, mbetet në nivelin e parashikuar në fillim të vitit (1.9 % e PBB). Për rrjedhojë, edhe borxhi publik mbetet në të njëjtin nivel me atë të parashikuar në fillim të vitit (65.5 % e PBB). Bilanci primar fiskal, kundrejt PBB, vijon të jetë në terma pozitivë.

Së dyti, krijohet fondi i nevojshëm për dhënien e shpërblimit të pensionistëve në fund të vitit. Shpërblimi për çdo pensionist është 3 mijë lekë, ndërsa numri total i pensionistëve përfitues është 663 227 mijë. Fondi total për këtë shpërblim është 1.99 milionë lekë. Ky fond është

parashikuar të përballohet nga reduktimi i shpenzimeve kapitale me 1.59 milionë lekë, si dhe nga buxheti i ISSH-së me 400 milionë lekë.

Së treti, bëhen disa rialokime midis zërave të shpenzimeve buxhetore, pa ndryshuar totalin e tyre, për të siguruar:

- Shtesën me 70 milionë lekë të shpenzimeve për bonusin e lindjeve, për shkak të rritjes së numrit të lindjeve. Kjo shtesë mbulohet nëpërmjet kursimeve në shpenzimet e personelit.

- Shtesën me 300 milionë lekë të shpenzimeve për skemën e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë së kufizuar, për pagesën e invaliditetit të kategorisë së invalidëve që nuk plotësojnë kriteret për marrjen e pensionit të invaliditetit. Kjo shtesë mbulohet nga reduktimi në të njëjtën masë, i transfertës buxhetore për ISSH-në.

- Shtesën me 235 milionë lekë të shpenzimeve për fondin rezervë të buxhetit të shtetit, për të krijuar rezervën e nevojshme pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

- Shtesën me 12.8 milionë lekë të shpenzimeve për subvencionimin e kredive të strehimit, për të përballuar nevojat shtesë pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019. Kjo shtesë mbulohet nga kursimet, në të njëjtën masë, të investimeve të brendshme në programin e strehimit.

Paraqitja e ndryshimeve buxhetore me akt normativ të Këshillit të Ministrave është një praktikë e ndjekur prej vitesh, e cila bazohet në nenin 101 të Kushtetutës dhe në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese. Kriteret për nxjerrjen e akteve normative janë nevoja, urgjenca dhe përkohshmëria. Në rastin konkret, ndryshimet buxhetore janë të nevojshme dhe urgjente, pasi krijojnë mundësinë për mbështetjen sociale të disa shtresave në nevojë, në fund të vitit. Përkohshmëria e aktit normativ argumentohet me faktin që ai vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë deri në 45 ditë. Brenda këtij afati, që është data 7 shkurt 2020, Kuvendi duhet ta miratojë aktin normativ me ligj.

Para se të arrij te konkluzionet, do të kaloj te rekomandimet që kanë të bëjnë objektivin kryesor të ekonomisë së vendit për vitin 2020, si dhe për periudhën afatmesme 2020-2022, mbetet vijimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe forcimi i stabilitetit makroekonomik të vendit. Ky objektivi duhet të arrihet nëpërmjet vijimit të thellimit të mètejshëm të politikave ekonomike, si më poshtë:

- Përmirësimi i administrimit të të ardhurave nëpërmjet aplikimit të një sistemi të thjeshtë e të barabartë tatimor, ruajtjes së normave të moderuara tatimore, si dhe reduktimit të informalitetit e evazionit fiskal. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim do të luajë fushata e fiskalizimit, e cila duhet të mbështetet në një strategji afatmesme gjithëpërfshirëse.

Rritja e cilësisë së shpenzimeve publike, duke u dhënë prioritet investimeve, të cilat luajnë rolin kryesor në rritjen ekonomike.

- Reduktimi i vazhdueshëm i deficitit buxhetor, për ta mbajtur borxhin publik në trajektore rënëse dhe për të zbutur risqet ndaj goditjeve të mundshme.

- Vijimi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe moslejimi i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura, me qëllim shlyerjen e të gjithë stokut të tyre deri në mes të vitit të ardhshëm.

- Përmirësimi i menaxhimit të projekteve të partneriteteve publike-private, nëpërmjet monitorimit rigoroz dhe vlerësimit të risqeve, si dhe rritjes së rolit mbikëqyrës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Duhet të ketë një proces të unifikuar për përgatitjen, caktimin e rendit të përparësisë dhe vlerësimin e të gjitha projekteve të investimeve publike.

- Vijimi dhe thellimi i reformave në sektorin e energjisë elektrike për reduktimin e humbjeve financiare, reduktimin e detyrimeve të prapambetura midis shoqërive, si dhe përmirësimin e menaxhimit. Në këtë kuadër, duhet të vijojë zbatimi i planit të rimëkëmbjes financiare, të bashkërenduar me Bankën Botërore, për ristrukturimin e thellë të këtij sektori në vitin 2020, duke krijuar një bursë energjie dhe duke realizuar ndarjen funksionale të shoqërisë së shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Përmirësimi i menaxhimit të borxhit publik dhe likuiditetit, duke synuar uljen e vazhdueshme të afatit të maturimit, dhënien prioritet të instrumenteve afatgjata të borxhit dhe zhvillimin e produkteve të reja financiare.

- Thellimi i reformës në sistemin financiar, duke synuar rritjen e kreditimit të ekonomisë, forcimin e konkurrencës midis institucioneve financiare, si dhe forcimin e kuadrit rregullator e mbikëqyrës. Për këtë kërkohet një bashkëpunim më i madh midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë.

Si konkluzion, ndryshimet buxhetore, përmes këtij akti normativ, mundësojnë sigurimin e mbështetjes financiare ndaj pensionistëve dhe shtresave të tjera sociale në nevojë. Kjo mbështetje sigurohet pa prekur treguesit kryesorë makroekonomikë të financave publike. Ajo

sigurohet përmes rialokimeve të shpenzimeve buxhetore midis ministrive dhe institucioneve, në përputhje me shkallën e realizimit të tyre, duke ndikuar edhe në optimizimin e shkallës së realizimit të planit të shpenzimeve korrente e kapitale.

Mbështetur në argumentet si më lart, ju sugjeroj miratimin e aktit normativ.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, Blerina!

Nga Ministria e Financave, fjala për zotin Haxhi.

Elton Haxhi - Faleminderit!

Urime dhe suksese për detyrën, në radhë të parë!

Nuk kam shumë për të shtuar në lidhje me prezantimin e aktit, pasi relatorja bëri një prezantim ezaurues të të gjitha elementeve të tij, por më lejoni të informoj komisionin për ecurinë e zbatimit të pagesës së bonusit. Pagesa e bonusit filloi menjëherë pas miratimit të aktit normativ në datën 24.12.2019, sipas një skeduli të mirë përcaktuar dhe të publikuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Vlen të theksohet se deri në datën 31 dhjetor 2019 u shpërndanë efektivisht mbi 65 % e shumës së parashikuar të totalit të bonuseve dhe pjesa e mbetur kryesisht lidhet me ata pensionistë, të cilët e tërheqin bonusin nëpërmjet zyrave të Postës Shqiptare, pasi për ata pensionistë, të cilët e tërheqin në llogari bankare, transferta është likuiduar brenda vitit 2019.

Edhe një herë doja të theksoja se ky bonus siguron ruajtjen e treguesve kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme duke e forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Mendoj se tani erdhi momenti për të bërë pyetje dhe për të mbajtur disa qëndrime për çështjen, kështu që, kolegë, ju ftoj të merrni fjalën.

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Zoti zëvendësministër, pyetja e parë është: pse pensionistët që i merrnin pagesat nëpërmjet llogarive bankare e kanë marrë bonusin dhe ata që i marrin nëpërmjet postës nuk e kanë marrë? E para.

E dyta: sa është numri i kontributorëve për sigurimet shoqërore dhe sa është numri i atyre që përfitojnë nga këto, ose thënë ndryshe, sa është numri i atyre që paguajnë sigurime (i punëmarrësve) dhe sa është numri i pensionistëve që përfitojnë nga sigurimet?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A mund t’ju bëj një pyetje, zoti Haxhi? Doni që t’i grumbulloni pyetjet e më pas të përgjigjeni, apo do të bëni pyetje-përgjigje?

Elton Haxhi – Faleminderit!

Në lidhje me mospagesën apo me progresin në lidhje me pagesën e atyre që e tërheqin në zyrat e postës, është çështje e paraqitjes së personave përfitues në zyrat e postës. Pra, në momentin që ata paraqiten në zyrat e postës bëhet edhe pagesa. Ne raportuam progresin në lidhje me tërheqjen, pra jo me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Koncepti i bonusit këtu bie. Ata e morën për festat me një qëllim të caktuar dhe qëllimi ishte kalimi i festave për atë sa mund t’i sjellë lumturi një 3 mijë lekësh i ri pensionistëve. Kështu që në këtë kontekst do të thosha se dhënia e bonusit e humbet qëllimin. Në qoftë se pensionisti është paraqitur te posta para dhjetorit, sepse nuk ma merr mendja se ka pensionistë që të durojë të marrë lekët pas dhjetorit, dhe në vazhdimësi, pyetja është: kur do t’u jepen këto lekë?

Elton Haxhi – Ky progres nuk ka lidhje me pamundësinë për t’i paguar. Pra ne kemi qenë gati t’i paguajmë edhe para dhjetorit, por në dijeninë tonë ka pensionistë që nuk janë paraqitur, qoftë sepse nuk kanë qenë prezentë në territorin shqiptar, qoftë për arsye të tjera.

Pra, nuk ka asnjë pensionist që ka shkuar dhe nuk e ka marrë bonusin.

Në lidhje me numrat, numrin e kontributorëve mund t’ua vëmë në dispozicion pas seancës, numri i përfituesve është në relacion, është 663 mijë e 227.

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Së pari, ju uroj mirëseardhjen, kryetare! Është kënaqësi dhe privilegj. Ju uroj suksese!

Lidhur me aktin normativ që propozojmë për ndryshimin e buxhetit 2019, në mos gaboj, është i dyti akt normativ që ndërhyr në buxhetin 2019. Pra, kemi pasur një në dhjetor dhe ky tani.

Normalisht, akti normativ vjen si një emergjencë për rialokime fondesh dhe besoj se ky akt normativ ka përfshirë edhe emergjencën e situatës së krijuar nga tërmeti. Meqenëse kjo

situatë ka një faturë financiare, që ende nuk jemi në dijeni të vlerës totale që do të ketë, por mendoj që buxheti 2019 dhe ky akt normativ ka marrë parasysh emergjencat e para që duhen zgjidhur.

Pasojat e tërmetit janë një zinxhir i gjatë për t'u kompletuar, por mendoj që fillon siç e dimë të gjithë me përmbushjen e detyrimit të bonusit të qirasë që ka dalë si detyrim i parë.

Në këtë akt normativ ju parashikoni një shtesë fondi për subvencionin e kredive të strehimit, por unë mendoj se duhet të jetë një fond që shkon për bonusin e qirasë 12.8 milionë lekë të rinj që keni parashikuar në këtë ndryshim buxheti.

Me këtë rast, meqenëse të gjithë qytetarët janë të interesuar të dinë se si procedojmë dhe në cilat situata financiare ndodhemi aktualisht për të përballuar emergjencat e para dhe ato besoj janë përmbushja e detyrimit për bonusin e qirasë për të gjithë aplikuesit, familjet që e kanë kërkuar atë, do të doja të dija nëse mund të na informoni, kjo shtesë fondi që nuk është shumë në fakt, jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për këtë, sa janë në total kërkesat që tashmë janë miratuar për bonusin e qirasë për të gjitha zonat e prekura dhe sa keni arritur t'u përgjigjeni, sepse buxheti i vitit 2019 besoj janë fondet e para që shkojnë në këtë drejtim, sa është numri i familjeve që e kanë përfituar tashmë bonusin e parë, të paktën, dhe pse po vonohet për pjesën e madhe të familjeve që ende presin që ta marrin atë?

Në këtë rast, do të doja të pyesja që përveç fondit prej 13 milionë, fondi i akumuluar nga donacionet e tjera a është vënë në përdorim apo mendohet të vihet shpejt në funksion të përmbushjes qoftë edhe të detyrimit për bonusin e qirasë, apo do të ruhet për fazat e rindërtimit? A është menduar të përdoret ai fond që ekziston tashmë, në mënyrë që të gjitha familjet ta kenë sa më shpejt bonusin e qirasë? Në çfarë faze jemi me realizimin e këtij detyrimi?

Pyetja tjetër që unë kam është: a keni shtesë fondi lidhur me bonusin e bebeve, sepse thoni që ka një lindshmëri të madhe, ky është një lajm i mirë, kështu që shpresoj të na jepni ndonjë shifër më konkrete se sa kanë qenë lindjet në vitin 2019 në Shqipëri? Me këtë rast na shpjegoni edhe për bonusin e bebeve, pra sa u takon lindjeve, përfitojnë të gjithë shqiptarët që jetojnë në Shqipëri apo edhe ata jashtë saj? Shtesa e fondit tregon që kemi gjëra të mira për të cilat duhet të gëzohemi. Gjithashtu, ju keni një shtesë fondi prej 300 milionësh për kategorinë e invalidëve. Kjo shtesë fondi do të thotë që kjo kategori është shtuar në Shqipëri? Në planifikimet e para ju keni parashikuar më pak fonde sepse kanë qenë më të pakta familjet në nevojë, apo

meqë sot po bëjmë këtë shtesë fondi dhe kemi më shumë aplikime do të thotë që janë shtuar apo nuk ishte parashikuar mirë fondi në fillim?

Këto ishin pyetjet që kisha.

Faleminderit!

Elton Haxhi – Një shtesë për pyetjen e mëparshme. Totali i kontributorëve në vitin 2018 ka qenë 752 383, në fund të vitit 2019 është 780 000. Pyetjeve të zonjës deputete do t'i përgjigjet zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Akti normativ që ju po diskutoni sot ka dy elemente të rëndësishme, njëri është shpërblimi i pensionistëve dhe tjetri ka të bëjë me emergjencën e tërmetit dhe kjo tregon pikërisht atë se pse ky ndryshim në buxhet është bërë me akt normativ dhe pse e bën emergjent. Pavarësisht se kostoja e tërmetit ishte vetëm 1 muaj, pasi ishte fillimi i situatës, ky akt normativ adreson disa probleme emergjente. Në radhë të parë ka parashikuar disa fonde emergjente për bonusin e qirasë, ndërkohë që ju jeni në dijeni, duke ditur edhe situatën në terren, që qiraja nuk filloi menjëherë në dhjetor. Pra, kemi pasur shumë pak kërkesa, normalisht dhjetori kishte situatën e strehimit nëpër hotele dhe mund t'ju them që kemi shpenzuar 270 milionë lekë vetëm gjatë muajit dhjetor për pagesën e hoteleve në të cilat qëndruan qytetarët.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij akti normativ ne e kemi rritur, sepse fondi rezervë kishte mbaruar dhe për çdo emergjencë të mundshme që mund të na dilte ditët e fundit të vitit vendosëm 235 milionë lekë në fondin rezervë, për të qenë të përgatitur për çdo emergjencë. Nga ky fond janë përdorur 70 milionë për inspektimet e godinave në disa qytete për aq shpenzime sa ishin bërë deri në atë moment dhe më pas ato iu kaluan bashkive. Nuk mund t'ju them në këtë moment sa është përdorur, por 70 milionë nga fondi rezervë janë alokuar. Në mbyllje të vitit 2019 shpenzimet që kemi konsumuar nga buxheti i shtetit për situatën e tërmetit janë bonusi i qirasë pjesërisht me aq pak sa mundëm ta fillonim procesin, pasi ju e dini që janë edhe vendimet e këshillit për të miratuar familjet e të tjera është një proces i gjatë, pagesën e hotelit për qytetarët që qëndruan nëpër hotele dhe shpenzimet për inspektimet, përveç shpenzimeve të zakonshme të administratës që u mor me të gjitha këto, por ato ishin brenda buxheteve të tyre institucionale.

Për vitin 2020 kërkesat që kemi deri tani për bonusin e qirasë janë 2,6 miliardë lekë. Ne vazhdojnë të na vijnë dhe të azhurnohen vendimet e këshillave të këtyre bashkive, të cilat janë ndikuar nga situata e tërmetit, por deri tani 2,6 miliardë është kërkesa zyrtare. Ne kemi çelur një fond të pjesshëm sa për të përballuar emergjencën 10 deri në 20% të nevojave për momentin, si

dhe jemi të gatshëm në çdo moment ku ka kërkesë emergjente për ta shpërndarë fondin që kemi miratuar në buxhetin e vitit 2020. Ne miratuam një fond emergjence 1 miliard lekë, por ndërkohë kemi edhe të gjithë fondin e rindërtimit, ju e dini që është 20 miliardë lekë së bashku me donacionet, kështu që i kemi të gjitha mundësitë për të përballuar çdo lloj nevojë që ka të bëjë në radhë të parë me bonusin e qirasë dhe pastaj me rindërtimin.

Në lidhje me donacionet mund t'ju them që deri tani nuk janë prekur, por janë bërë pjesë e fondit të rindërtimit, siç e kemi diskutuar kur diskutuam buxhetin 2020, dhe ato do të bashkohen me kontributin e buxhetit të shtetit dhe do të përdoren në destinacionin që do të vendosë Komiteti i Rindërtimit sipas ligjeve përkatëse që kanë dalë deri tani.

Bonusi i bebeve aktualisht jepet edhe për bebet që lindin në Shqipëri edhe për ato që lindin nga shqiptarët jashtë atdheut. Ka vërtet një interes, në këto momente nuk mund t'ju jap shifra sa bebe kanë lindur, por është një politikë që ka ecur pozitivisht, prandaj me aktin normativ është vlerësuar që të shtohet ky fond. Fondi që është shtuar për pagesën e PAK-ut dhe të ndihmës ekonomike ka lidhje vetëm me një ndryshim ligjor që është bërë për përfitimet nga skemat e ndihmës shoqërore, është vetëm një zhvendosje nga skema e sigurimeve shoqërore në skemën e paaftësisë, 300 milionë.

Pra, ne ua kemi marrë sigurimeve shoqërore fondin që ishte parashikuar dhe ata trajtohen tani si të paaftë nëpërmjet skemës së PAK-ut.

Milva Ekonomi – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Rryçi.

Krenar Rryçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju uroj mirëseardhjen në komisionin tonë, një komision mjaft i rëndësishëm, kështu që ju duhet ta drejtoni me shumë seriozitet!

Kam një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë. Dua të di nëse për fondet që kanë ardhur dhe janë akumuluar nga donatorët që ndodhen jashtë, për emergjencën civile, keni ndonjë shifër konkrete? Si do të shpërndahen këto fonde dhe a ka filluar shpërndarja e tyre?

Kam një pyetje tjetër, një merak që e kanë edhe qytetarët në lidhje me disa donatorë shqiptarë, të cilët kanë marrë përsipër mbledhjen e fondeve, madje fonde marramendëse. A janë futur këto fonde në buxhet? A i kontrolloni ju ata? Ka apo nuk ka transparencë për këto fonde, pasi ka shumë zëra që me këto fonde po abuzohet? Deri tani nuk ka asnjë lloj shpërndarjeje dhe manovrimi në lidhje me këto fonde, siç është ai që ka marrë përsipër Elvis Naçi, ndërkohë që ai

thotë se ka mbi 10 milionë euro të grumbulluara, fondacioni tjetër i kryesuar nga Arbër Hajdari, por sipërmarrjen këtu duhet ta ketë shteti, sepse ai është donatori kryesor. Këto donatorë mund të afrohen duke dhënë kontributin e tyre ashtu sikurse mund ta japim edhe ne për gjithë qytetarët, por jo t'i fusim në llogari personale dhe t'i përdorim siç duam ne, pasi ato janë fonde për qytetarët shqiptarë dhe për emergjencat civile. A keni ju ndonjë shifër në lidhje me këtë procedurë apo jo?

Faleminderit!

Elton Haxhi – Në lidhje me vlerën e fondit të rindërtimit, deri më sot, përveç kontributit nga buxheti i shtetit, kontributet nga donatorët herën e fundit që e kam parë kanë qenë diku te 15 milionë euro, pa përfshirë kontributin e dhënë nga Bashkimi Europian pak a shumë në të njëjtën vlerë, pra 15 milionë euro kanë qenë nga donatorë të tjerë. Gjithsesi, në lidhje me gjendjen e fondit në çdo moment mund t'i referoheni *website*-t të Ministrisë së Financave, ku bëhet transparente çdo ditë sa është gjendja e akumuluar e këtij fondi në llogaritë e hapura nga qeveria për këtë qëllim. Ne kemi bërë gjithë transparencën dhe përpjekjet për të promovuar dhe për të sensibilizuar të gjithë qytetarët për kontributet në llogaritë e hapura nga qeveria në bankat e nivelit të dytë, por edhe në Bankën e Shqipërisë për institucionet qeveritare, për të dhënë kontribut në këto llogari. Qytetarët apo organizatat e tjera jofitimprurëse natyrshëm që kanë dhënë kontributin e tyre duke mbledhur donacione për llogari të tyre. Është një komitet për rindërtimin ku donatorët më të rëndësishëm, të cilët janë identifikuar, janë pjesë e këtij komiteti dhe diskutojnë në këtë komitet në lidhje me prioritetet dhe koordinohen me njëri-tjetrin në lidhje me ndërhyrjet që bëjnë për situatën e emergjencës, por më duhet t'ju them që transparenca e këtyre organizatave jofitimprurëse është detyrimi i tyre nuk jo i qeverisë. Qeveria ka për qëllim dhe për detyrim të bëjë transparent përdorimin e fondeve në llogaritë e saj, pra donacionet që janë dhënë nëpërmjet *e-Albania* dhe kanaleve të tjera zyrtare dhe detyrimi i këtyre organizatave jofitimprurëse është që të bëjnë transparencën për përdorimin e fondeve të tyre.

Komiteti i Rindërtimit dhe akti normativ që rregullon rindërtimin përcaktojnë qartë rregullat e monitorimit dhe të transparencës të donacioneve që kanë ardhur në kanale zyrtare, ndërsa sa u takon organizatave jofitimprurëse është në nivel koordinimi, pasi ato japin llogari për ndërhyrjet dhe koordinohen se ky i përdorin paratë e tyre në këtë komitet. Baza ligjore është duke u përmirësuar në lidhje me mekanizmat financiarë për rindërtimin, por detyrimet e tyre për transparencë i kanë vetë organizatat.

Milva Ekonomi – Zoti Haxhi, mendoni se jemi mjaftueshëm të qartë sa u takon ndryshimeve që po bëhen në buxhet dhe pse ka lindur nevoja e ndryshimeve?

Kolegë a keni ndonjë gjë tjetër që doni të shtroni për diskutim në mënyrë që ta kuptoni më mirë? Nuk ka.

Kalojmë në votim?

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Roshi e ka fjalën.

Artur Roshi – Pyetja që unë bëra u bë me qëllimin për të treguar se sa janë njerëzit që sigurohen dhe sa nga ata përfitojnë nga sigurimet e tyre. Sipas shifrës që ju më dhatë ka një diferencë shumë të vogël, diku te 100-150 mijë persona. Dua t’ju them se ky fakt është shqetësues, sepse me rrjedhjen e pjesës që sigurohet, pra të atyre që kërkojnë punë nëpër vendet e Europës do të thotë që numri i njerëzve që sigurohen apo i punëmarrësve ka një tendencë për t’u ulur më shumë. Në këtë kontekst kemi një konstante të atyre që përfitojnë dhe është në rënie numri i atyre që kontribuojnë. Me ligjin e ri dhe skemën e re të pensioneve, e cila duhet të qëndrojë në treg sipas logjikës, një logjikë që e ndjekin të gjitha vendet e Europës, po shkon drejt kolapsit.

Me këtë rast dua t’i bëj thirrje Ministrisë së Ekonomisë që t’i drejtohet si partner biznesit dhe jo me demagogji, pasi ka ardhur koha që demagogjia të lihet mënjanë. Në këtë kontekst dua t’ju them se prekja e shpenzimeve të zërit të buxhetit nuk është ajo që duhej bërë për dhënien e shpërblimeve pensionistëve, sipas meje, prandaj gjykoj që qeveria duhej të kishte bërë alokime nga shpenzime të tjera apo nga investime të pakryera, por jo nga shpenzimet e zërit të buxhetit për sigurimet shoqërore. Për mendimin tim marrja e fondit nga sigurimet shoqërore është e gabuar.

Dëgjoja dje apo pardje zonjën Ibrahim, drejtoreshë e Tatimeve, e cila u shpreh se duke u vendosur çipa inspektorëve do të goditej informaliteti dhe njëkohësisht edhe korrupsioni brenda radhëve të tatimeve. Nuk besoj se të ardhurat do të rriten duke u vendosur çipa punonjësve të tatimeve, pasi mendoj se edhe drejtoreshën e ka kapur sëmundja e trendit të teknologjisë, gjë që ka kapur të gjithë qeverinë tuaj, e cila po shpenzon paratë e buxhetit të shqiptarëve, duke u befasuar para teknologjisë, sigurisht ajo të impresionon, por jo duke lëshuar veten pa frerë. Çdo dikaster sillet njësoj si një kalama që kërkon t’u shpenzojë paratë prindërve me lodra

teknologjike, prandaj mendoj që kjo lajthitje e qeverisë duhet përmbajtur, sidomos brenda Ministrisë së Financave.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zonja Gjylameti për një ndërhyrje. Më pas do të kalojmë në votim.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetare!

Pikë së pari e shoh më se të nevojshëm këtë akt normativ me funksionin bazë të rishikimit të të gjitha shpenzimeve ndërmjet institucioneve dhe ministrive përkatëse, por mbi të gjitha me faktin apo parimin bazë, duke mos prekur ato që janë treguesit makrofinanciarë, që janë treguesit bazë. Në relacionin tim u mundova të isha sa më e qartë për t'ju treguar që nuk është cenuar asnjë nga treguesit makrofinanciarë qoftë në pjesën e trendit rënës të borxhit publik, qoftë në pjesën e deficitit buxhetor, por mbi të gjitha në pjesën për shpenzimet dhe të ardhurat. Në situata të tilla, siç ishte ajo e fundvitit 2019, qoftë me pjesën e dëmeve të tërmetit të nëntorit, qoftë me pjesën e një ndihmës për shtresat në nevojë apo për pensionistët mendoj se është mëse e nevojshme. Ajo që do të kërkoja në mënyrë që ta bënim si çdo herë tjetër kur kemi pasur rishikime të buxhetit nëpërmjet akteve normative është planifikimi më i kujdesshëm në pjesën e të ardhurave apo edhe të shpenzimeve në mënyrë që të jenë sa më të realizueshme dhe të mos kemi rishikime sa u përket planeve, por rishikimet për pjesën e alokimeve mendoj se janë të rëndësishme, sidomos në situata të tilla.

Unë vazhdoj t'i inkurajoj institucionet edhe me pjesën e përdorimit të teknologjisë, pasi është shumë e rëndësishme që teknologjia të jetë në funksion të një miradministrimi për pjesën e tatimeve, po ashtu edhe për të gjitha institucionet përkatëse. Nga ana tjetër më duhet të theksoj faktin që ndryshimi në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore nuk ka të bëjë me ulje të buxhetit për ndonjë arsye të caktuar, por ka të bëjë me rialokim të tij. Nëse shohim shifrat e buxhetit të vitit 2019, po ashtu edhe ato të vitit 2018, do të shohim që në skemën e pensioneve ka një rritje të atyre që janë kontributorë, i cili është një tregues shumë pozitiv për pjesën se si do të jetë bilanci ndër vite i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Nëpërmjet asaj reforme të thellë që u ndërmor në vitin 2015, reforma e pensioneve, sot kemi një situatë shumë më të mirë. I inkurajoj përsëri institucionet që të vazhdojnë të bëjnë punën e tyre sa i takon formalizimit të tregut të punës, por mbi të gjitha formalizimit të ekonomisë, sepse dimë që ka ende punë për të bërë pasi një pjesë e mirë e ekonomisë shqiptare ka shifra që janë informale. Ne mund t'i rrisim të ardhurat

dhe më pas të rrisim shpenzimet për investime që kontribuojnë në rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Hedhim në votim aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 98/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar””.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Duke parë agjendën do të kalojmë në çështjen tjetër që kemi në rendin e ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”. Ndërkohë e kemi lënë që zonja Kushi do të mbledhë të gjithë informacionin për aktin normativ “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438/1998”. Sugjeroj të bëjmë një pushim të vogël dhe më pas të kalojmë në takimin e dytë.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti